

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

Fakulteti i Filologjisë

Emërtimi i lëndës: **Gjuhësi ballkanike**

Departamenti: Gjuhë Shqipe

Niveli i kursit: **Master**, lëndë e detyrueshme (obligueshme)

Viti V, Semestri: IX

Fondi i orëve: 2+0

Kodi:

Vlera në kredite ETCS: 6

Koha dhe vendi i ligjëratave:

Mësimdhënësi: dr. Sedat Kuçi, profesor i rregullt

Zyra 132 (69), tel. 038/ 222 970; e-mail: sedat.kuqi@ uni-pr.edu

Konsultime: e hënë 12,00-13,00; e martë 12,00-13,00;

Qëllimi i kursit:

Synimi i këtij kursi është të theksojë aspektet e studimit areal rajonal dhe ndërdisiplinor të studimeve ballkanike. Gjuhët në këtë rast shihen si mjet komunikimi dhe të kuptuarit e ndërsjellë të shoqërive që jetojnë në një hapësirë pak a shumë të përbashkët dhe kulturave përkatëse. Para studentëve do të shtrohen detyrat e studimit të veçorive gjuhësore dhe kulturore të Ballkanit. Duke shqyrtuar gjuhët dhe dialektet, letërsitë dhe folklorin, trashëgiminë kulturore dhe historinë e përbashkët të Ballkanit, studentët do të aftësohen për ta kuptuar më mirë kulturën e vet dhe të tjerëve.

Rezultatet e pritura:

Në përfundimin e këtij kursi studenti i vlerësuar pozitivisht do të jetë në gjendje:

- Të njohë elementet kryesore të historisë së përbashkët të popujve të Ballkanit;
- Të njohë kontaktet e gjuhëve në Ballkan, statusin dhe pozitën e tyre;
- Të dallojë elementet kryesore të veçorive të përbashkëta gjuhësore të gjuhëve të Ballkanit;
- Të analizojë veçoritë e përbashkëta gjuhësore;

Metodologjia e mësimdhënies:

Orët do të organizohen në formë ligjëratash.

Literatura e nevojshme:

Shaban Demiraj: Gjuhësi ballkanike, Shkup 1994, botim i ri Tiranë 2004.

Rexhep Ismajli: Gjuhë standarde dhe histori identitetesh, Tiranë, 2005.

Besim Bokshi: Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike, Rilindja, Prishtinë, 1984. Botimi i dytë, ASH, Tiranë, 2009.

Maria Todorova: Imagining the Balkans, Oxford University Press 2009.

Petya Assenova: Balkansko ezikoznanie, V. Ternovo, 2002.

Christian Sandfeld: Linguistique balkanique, Paris, 1930, 1935.

Metodat e vlerësimit (me test):

Angazhimi dhe pjesëmarrja aktive: 20%

Vijimi i rregullt: 5%

Provimi përfundimtar me test 75%

Gjithsej 100%

Plani i detajizuar

- Java 1.** Objekti i studimit të Gjuhësisë ballkanike. Dukuritë e përbashkëta të gjuhëve të Ballkanit. Kontributi i autorëve të ndryshëm për problemet e gjuhësisë ballkanike.
- Java 2.** Gjendja gjuhësore e Gadishullit Ballkanik në lashtësi I. Gjuhët substratë. Gadishulli Ballkanik dhe gjuhët e Ballkanit. Greqishtja e vjetër dhe dialektet e saj. Maqedonishtja e vjetër. Fqinjët veriperëndimorë të grekëve të vjetër – Epiri (Epiros).
- Java 3.** Gjendja gjuhësore e Gadishullit Ballkanik në lashtësi II. Ilirët, fiset ilire dhe shtrirja e tyre gjeografike. Ilirishtja gjuhë kentum apo satem? Trakasit, fiset trakase, origjina dhe gjuha e tyre. Romanizimi i Gadishullit Ballkanik.
- Java 4.** Gjendja e sotme gjuhësore në Gadishullin Ballkanik I. Shkaqet e ndryshimit gjuhësor të Gadishullit Ballkanik. Ishujt gjuhësorë. Gjuha shqipe dhe vendet ku flitet ajo. Emërtimi i shqipes me mbiemrin e arbëneshe-e arbëreshe dhe ndajfoljen arbënisht-arbërisht. Hipotezat për prejardhjen - burimin e gjuhës shqipe. Arsyet e dokumentimit të vonshëm të shqipes. Shqipja – gjuhë indoevropiane. Dukuritë kryesore ballkanike të gjuhës shqipe.
- Java 5.** Gjendja e sotme gjuhësore në Gadishullin Ballkanik II. Greqishtja e re dhe vendet ku flitet ajo. Dokumentimi shkrimor i saj. Letrarishtja popullore “dhimotiqi” dhe letrarishtja e “pastruar” “katharevusa”. Greqishtja gjuhë indoevropiane e tipit sintetik – analitik. Dukuritë kryesore ballkanike të greqishtes së re.
- Java 6.** Gjendja e sotme gjuhësore në Gadishullin Ballkanik III. Rumanishtja dhe vendet ku flitet ajo. Prejardhja e rumanishtes. Arsyet e shkrimit të vonshëm të rumanishtes. Dialektet e rumanishtes. Dukuritë kryesore ballkanike të rumanishtes. Gjuhët slave të Ballkanit. Bullgarishtja dhe vendet ku flitet ajo. Dokumentimi me shkrim i bullgarishtes. Dialektet e bullgarishtes. Dukuritë kryesore ballkanike të bullgarishtes.
- Java 7.** Gjendja e sotme gjuhësore në Gadishullin Ballkanik IV. Maqedonishtja dhe vendet ku flitet ajo. Maqedonishtja dhe bullgarishtja. Sistemi tri nyjash i maqedonishtes. Dukuritë kryesore ballkanike të maqedonishtes. Serbokroatishtja dhe vendet ku flitet ajo. Dokumentimi me shkrim dhe formimi i gjuhës letrare serbokroate. Dukuritë kryesore ballkanike të serbokroatishtes.
- Java 8.** Bashkëpërkimet në fushën e fonetikës. Bashkëpërkimi – prania e zanores ë në bullgarishte, rumanishte dhe shqipe. Dukuria e rotacizmit të bashkëtingëllore n në gjuhën shqipe (në toskërishte) dhe në rumanishte. Karakteri dhe vend i theksit në gjuhët ballkanike. Mungesa e dallimeve kuantitative tek zanoret në gjuhët ballkanike.
- Java 9.** Konsonantizmi në gjuhët e Ballkanit. Bashkëpërkimi i rasave gjinore dhe dhanore në gjuhët e Ballkanit. Bashkëpërkimi i tyre në greqishte, në shqipe, në rumanishte, në maqedonishte, bullgarishte. Shpjegimi i burimit të kësaj dukurie nga studiues të ndryshëm.
- Java 10.** Prapavendosja e nyjës shquese – dukuri tipike e gjuhëve të ballkanit. Studiuesit që

janë marrë me studimin e kësaj dukurie. Hipotezat lidhur me burimin e kësaj dukurie në gjuhët e Ballkanit.

Java 11. Zhvillimi i nyjës së prapapavendosur në gjuhët e Ballkanit: rumanishte, shqipe, bullgarishte, maqedonishte.

Java 12. Mënjanimi i paskajores. Paskajorja në gjuhët indoevropiane. Mënjanimi i paskajores në greqishte, bullgarishte, maqedonishte, në serbishte, rumanishte.

Java 13. Dukuria e paskajores në gjuhën shqipe. Mendimet e gjuhëtarëve për mënjanimin e paskajores në gjuhët e Ballkanit.

Java 14. Bashkëpërkimet në fushën e fjalorit I. Mendimi i gjuhëtarëve për bashkëpërkimet në gjuhët greke, latine, romane, shqipe, turke, sllave. Huazimet e gjuhëve ballkanike nga greqishtja e vjetër e mesme dhe e re. Huazimet latine dhe romane në gjuhët e Ballkanit. Huazimet latine në gjuhën shqipe.

Java 15. Huazimet sllave në gjuhët greqishte, rumanishte e shqipe. Huazimet turke në gjuhët e Ballkanit. Prapashtesat fjalëformuese të turqishtes në gjuhët e Ballkanit. Shprehjet frazeologjike të gjuhëvr të Ballkanit. Shpjegimi i burimit të frazeologjizmave në gjuhët e Ballkanit.

LLOGARITJA E NGARKESËS SË STUDENTIT KONTRIBUTI NË NGARKESËN E STUDENTIT

AKTIVITETI	ORË	DITË/JAVË	GJITHSEJ
LIGJËRATA	2	15	30
USHTRIME TEORIKE	1	15	15
KONTAKTET ME MËSIMDHËNËSIN KONSULTIMET PËR STUDENT NË JAVË 10 MIN.		15	150 MIN. = 2,5 ORË
KOLOKVIUME, SEMINARE	1	15	15
DETYRA TË SHTËPISË	2	2	4
KOHA E STUDIMIT VETANAK TË STUDENTIT(NË BIBLIOTEKË OSE NË SHTËPI)	3	15	45
PËRGATITJA PËRFUNDIMTARE PËR PROVIM	15	2	30
KOHA E KALUAR NË VLERËSIM (TESTE,KUIZ,PROVIM FINAL)	1,5	3	4,5
PROJEKTET, PREZANTIMET,ETJ.	1,5	1	1,5

NGARKESA TOTALE			146,5 ORË

$$146,5 : 25 = 5,86 \text{ KREDITE-ECTS}$$